REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE

THIRRJE

KONFERENCË NDËRKOMBËTARE

"RISI DHE QASJE GJITHËPËRFSHIRËSE NË GJUHËSI, MËSIMDHËNIE, PËRKTHIM, LETËRSI DHE KULTURË"

DATA: 4 dhjetor 2026

VENDI: Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

Seanca Plenare:

1. **Daniel Xerri**, Prof. Asoc. në Gjuhësi e Zbatuar dhe Mësimdhënie e Anglishtes për Folës të Gjuhëve të Tjera (TESOL), Universiteti i Maltës.

2. **Cristiana Osan**, Trajnuese e certifikuar për mësuesit e gjuhës angleze, DELTA (Diploma in Teaching English to Speakers of Other Languages)

3. **Dr. Isaak Papadopoulos**, Asistent Profesor i zhvillimit të aftësive të hershme të shkrimit e leximit, Departamenti i Edukimit dhe i Kujdesit për Fëmijërinë e Hershme, Universiteti Ndërkombëtar Helenik, Greqi

Departamenti i Gjuhës Angleze ka kënaqësinë të organizojë Konferencën e 16-të Ndërkombëtare, në vijim të orientimit ndërdisiplinor drejt zhvillimeve më të fundit teorike dhe praktikave bashkëkohore në fushat e gjuhësisë, mësimdhënies së gjuhëve të huaja, përkthimit, letërsisë dhe kulturës. Edicioni i vitit 2026 vendos theks të veçantë tek arsimi gjithëpërfshirës, duke vënë në qendër barazinë, pjesëmarrjen, përkatësinë, aksesueshmërinë dhe respektin për diversitetin gjuhësor e kulturor.

Frymëzuar nga qëndrimi i "British Council" për vitin 2026 mbi arsimin, konferenca mirëpret studime dhe kërkime shkencore mbi shumëgjuhësinë dhe ndërgjuhësinë; pedagogjia mbështetëse me bazë gjuhën; kurrikulat gjithëpërfshirëse dhe burimet mësimore; vlerësimin e barabartë; formimin e mësuesve; CLIL-in dhe edukimin në gjuhën angleze; aksesueshmërinë dhe të nxënit digjital/të mbështetur nga inteligjenca artificiale; si edhe qasjet gjithëpërfshirëse në studimet e përkthimit, letërsisë dhe kulturës. Pjesëmarrësit mund të trajtojnë politikat arsimore, praktikën në klasë, përvojën e nxënësve/studentëve, materialet mësimore, vlerësimin dhe zhvillimin profesional të mësuesve në kontekste të ndryshme arsimore.

Konferenca synon të bëjë bashkë studiues, pedagogë, mësues, kërkues shkencorë dhe profesionistë të fushës, me qëllim shkëmbimin e gjetjeve kërkimore, përvojave dhe praktikave novatore përmes kontributeve origjinale. Punimet e paraqitura në konferencë do të shqyrtohen për t'u botuar si pjesë e akteve të konferencës, duke kontribuar kështu në dialogun akademik kombëtar dhe ndërkombëtar mbi arsimin gjithëpërfshirës, të barabartë dhe që merr parasysh nevojat e nxënësve/studentëve.

Gjuhët e konferencës: Anglisht / Shqip

Adresa e e-mailit: konferenca.anglisht@unitir.edu.al

Data të rëndësishme:

- Afati për dërgimin e abstraktit: **20 nëntor 2026**
- Njoftimi për pranimin e abstraktit: **25 nëntor 2026**
- Afati për dërgimin e punimit të plotë: **29 janar 2027**